



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2022:051864

Datë: 06.07.2022

Numri i dokumentit: 03271965

**2022:079922**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale, Albina Varoshi-Haxhimusa, në çështjen penale kundër të pandehurës F.A-F, me vendbanim në rrugën “ ...”, numër 24, në Ferizaj, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, par.3, lidhur me par.1, të KPRK-së, si dhe të pandehurës S.F, me vendbanim në rrugën ‘...’, numër 4, në Ferizaj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor 185 par.1 nën par.1.4 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.323/2022, të datës 20.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të pandehurës F.A-F si dhe të pandehurës S.F, me datë 15.06.2022, mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 06.07.2022, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **E pandehura:**

**F.A-F**, e lindur më ....., në Mitrovicë, nga i ati B. dhe nëna F., e vajzërisë S., me vendbanim në Rrugën ‘...’, numër 24, në Ferizaj, me numër personal ..., me profesion frizere, e pa punë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, relacioni në mes të pandehurave/ gjinia e krushqisë vjehrrë-rejë, e pa dënuar më parë.

#### **E pandehura:**

**S.F**, e lindur më ..., në Shtime, me vendbanim në Rrugën ‘...’ numër 24, në Ferizaj, nga i ati S. dhe nëna I., e vajzërisë N., me numër personal ... ka të kryer shkollën e lartë Pedagogjike, e pensionuar, e gjendjes të mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, relacioni në mes të pandehurave/ gjinia e krushqisë rejë-vjehrrë, e pa dënuar më parë.

## JANË FAJTORE

### Sepse:

#### E pandehura: F. A-F

Me datë 04.03.2022, rreth orës 22:00h, në rrugën ‘...’, në Ferizaj, saktësisht në shtëpinë e tyre, e pandehura me dashje ka përdorur forcën fizike ndaj të dëmtuarës–vjehrrës së saj S.F, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale në mes tyre për shkak se e pandehura ka kërkuar nga bashkëshorti i saj që ta pastronte vajzën e tyre, ku pasi e dëmtuara e sheh se situata po acarohet mes të pandehurës dhe bashkëshortit të saj të cilët ishin nisur për të shkuar në banjo tek vajza, në atë moment edhe e dëmtuara shkon pas tyre dhe gjatë konfliktit verbal e pandehura e sulmon fizikisht të dëmtuarën duke e goditur me dorë në fytyrë.

**-Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 3, lidhur me nënparagrafin 3.1, të KPRK-së.**

#### II.E pandehura: S.F

Me datë, kohë, dhe në vendin e njëjtë, të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës, e pandehura me dashje ka përdorur forcën fizike ndaj të dëmtuarës rejës së saj-F.A-F, në atë mënyrë që pasi e pandehura ishte sulmuar nga reja e saj F., në atë moment e sulmon edhe e pandehura duke e kafshuar në dorë e majtë, me të cilin veprim i shkakton lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm për shëndetin.

**-Me këtë veprim ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën par.1.4 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 69 dhe 70 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPRK-së, i:

## **G J Y K O N**

### **Të pandehurën: F.A-F**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në periudhën kohore prej një (1) viti /afati i verifikimit/, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

### **Të pandehurën: S.F**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në periudhën kohore prej një (1) viti /afati i verifikimit/, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohen të pandehurat që secila në mënyrë individuale të paguajë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej nga 20€ /njëzetë euro/, obligohet e pandehura S.F, që në emër të ekspertizës mjeko ligjore të datës 25.03.2022, të e paguaj shumën prej 20€ /njëzet euro/, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, obligohen të pandehurat që secila veç e veç, të e paguajë shumën prej nga 30€ /tridhjetë euro/, të gjitha këto brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës dhe Aktakuza**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën e saj PP.II.nr.323/22, të datës 20.04.2022, ka ngarkuar të pandehurën F.A-F, nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3, lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe të pandehurën S.F, nga Ferizaj, për shkak të verës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1, nën par.1.4, të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 15.06.2022, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoi aktin akuzues, dhe gjyqtarja pasi që u bind se të pandehurat e kanë kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe

përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurave iu ofroi mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshme.

### **Deklarimet e palëve**

E pandehura F.A-F në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: e pranon fajësinë për veprën penale, e cila i vihet në barrë, ndihet e penduar për veprimin që i ka bërë, premtion gjykatës që më nuk do të përsërisë vepra të tilla, lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

E pandehura S.F në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: e pranon fajësinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, shton se i vjen keq për atë që ka ndodhur, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, ndihet thellë e penduar, i premtion gjykatës që më nuk do të përsërisë vepra të tilla apo te ngjashme, shton se që nga dita kritike nuk ka raporte të mira me bashkëshorten e djalit dhe se do të inicioj procedurë për shkëputje të bashkësisë familjare, e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që të pandehurat e kanë pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat e ngarkon Aktakuza, gjyqtarja e çështjes konform nenit 248 paragrafi 2, të KPPRK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurat, pasi pranimi i fajësisë është ne përputhje me nenin 248 si dhe provat materiale të shkresave të lëndës, në mënyrë vullnetare, duke i propozuar Gjykatës që të njëjtat të i shpall fajtores dhe të u shqiptoj nga një dënim të paraparë me ligj.

### **Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së, dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurat e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: raporti i oficerit i datës 04.03.2022, me numër të rastit 2022-CF-369, raporti fillestar i incidentit i datës 04.03.2022, me numër të rastit 2022-CF-369, deklaratat e të pandehurës F.A.-F të datës 04.03.2022, dhe të datës 25.03.2022, deklarata e të pandehurës S.F të datës 04.03.2022, deklarata e dëshmitarit G.F e datës 04.03.2022, me dhe datë 25.03.2022, forma

bazike për viktimat e dhunës në familje i datës 04.03.2022, foto-dokumentacioni i datës 04.03.2022, me numër të rastit 2022-CF-369, akt-Ekspertimi mjeko-ligjor i datës 25.03.2022 nga Dr.Vesa Kotori, raporti ditor i dhunës në familje i datës 04.03.2022, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë, dhe erdhi në përfundim se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabim faktik.

Meqenëse të pandehurat e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

### **Vlerësimi juridik i veprimeve të të pandehurave**

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurave ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat akuzohen, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin I- rë dhe II- të të këtij Aktgjykimi, të pandehurat me veprimet e tyre dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore kanë konsumuar elementet e veprës penale për të cilat ngarkohen.

### **Matja e dënimit**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurat, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe për të pandehurën F.A-F, gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale, si dhe në rastin konkret si rrethanë rënduese i mori faktin se vepra penale është kryer brenda raporteve familjare, ku e dëmtuar nga kjo vepër penale është nëna e bashkëshortit të saj-vjehrra, me të cilën deri ditën kritike kanë jetuar në të njëjtën shtëpi si dhe moshën e të dëmtuarës, e cila është e moshës së shtyrë.

Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, edhe për të pandehurën S.F, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale,

moshën e shtyrë të të pandehurës, si dhe në rastin konkret si rrethanë rënduese i mori faktin se vepra penale është kryer brenda raporteve familjare, ku e dëmtuar nga kjo vepër penale është bashkëshortja e djalit të saj, me të cilën deri ditën kritike kanë jetuar në të njëjtën shtëpi, si dhe secilës veç e veç, u vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurave si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK–ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

### **Shpenzimet e procedurës**

Sipas nenit 450 dhe 451 të KPPK–së, obligohen të pandehurat që secila veç e veç të paguajë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej nga 20€ /njëzetë euro/, obligohet e pandehura S.F, që në emër të ekspertizës mjeko ligjore të datës 25.03.2022, të e paguaj shumë prej 20€ /njëzet euro/, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, obligohen të pandehurat që secila veç e veç, të e paguajë shumë prej nga 30€ /tridhjetë euro/, të gjitha këto brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal**

**2022:079922, datë 06.07.2022**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtarja**

**Albina Varoshi-Haxhimusa**

**Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.